



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 3170 Prot.

Vlorë, më 09 . 10 .2018

VENDIM

Nr. 36, datë 28 . 09 .2018

PËR DHËNIEN E TITULLIT VENDOR “NDERI I QARKUT VLORË
Z. SKËNDER TENA”

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 28.09.2018 në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.112/2014 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM - së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr.23, datë 20.07.2017 për miratimin e Rregullores mbi procedurat e dhënies së “Titujve Vendorë të Nderit”, propozimit të Fondacionit Kulturor Mbarëkombëtar “Nermin Vlora Falaschi” dhe Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve “Petro Marko” Vlorë si dhe Vendimit të Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit në Këshillin e Qarkut Vlorë më datë 13.08.2018;

VENDOSI;

- 1.Ti jepet Titulli Vendor “Nderi i Qarkut Vlorë Z. Skënder TENA” me motivacion “Skulptor i dalluar i Vlorës, për kontribut dhe krijimtari me nivel të lartë etiko - artistik, gur themeli për jetën artistike dhe krijuesit e rinj”.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit në Këshillin e Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë Nr. _____ Prot, datë ____ . ____ .2018.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Sheshi “4 Heronjtë”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkivlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.
Tel: +355 33 421 600